



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 268, Datë 28.12.2020

MBI  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E  
“RREGULLAVE TË PËRDORIMIT TË TERMINALIT TË  
GAZIT NATYROR TË LËNGSHËM (GNL)” NË SHQIPËRI.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neneve 16 dhe 74, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 142/11 Prot, datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL)” për Shqipërinë.

**Konstatoi se:**

- Rregullat për përdorimin e terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL) për Shqipërinë u hartua si dokument në përputhje të neneve 16 dhe 74, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” të ndryshuar, si dhe bazuar në praktikën rregullatore në respektim të detyrimeve ligjore për strukturimin e akteve sekondare që i takojnë sektorit të Gazit Natyror si të përcaktuara në nenin 116, të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE inicion relacionin mbi fillimin e procedurës për miratimin e “**Rregullave të përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL)**” për Shqipërinë.
- Termat e përdorur në këto Rregulla kanë kuptimet e përcaktuara në Ligjin nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” të ndryshuar, dhe në aktet që përcaktojnë rregullimin e aktivitetit të energjisë dhe tregun e gazit.
- Rregullat rregullojnë në mënyrë të veçantë përshkrimin e terminalit të gazit natyror të lëngshëm, zhvillimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e terminalit, përdorimin e terminalit, marrëdhëniet kontraktuale dhe kushtet e përgjithshme të përdorimit të terminalit, rezervimin dhe përdorimin e Kapacitetit të Terminalit, rregullat e matjes dhe rregullat e shpërndarjes, publikimin e të dhënave dhe shkëmbimin e të dhënave,

dëmshpërblimin dhe rregullat e shitjes së GNL-së ose gazit natyror të Përdoruesit të Terminalit në një Procedurë të Hapur.

- Këto rregulla janë zhvilluar dhe zbatuar duke ndjekur parimet e përgjithshme të transparencës, mosdiskriminimit të Përdoruesve të Terminalit, sigurisë dhe besueshmërisë së Terminalit, si dhe efikasitetit teknik dhe ekonomik të përdorimit të Terminalit.
- Këto Rregulla do të zbatohen nga Operatori, Përdoruesi i Terminalit, si dhe subjekte të tjerë të energjisë, psh. pjesëmarrësit në tregun e gazit që synojnë të bëhen përdorues të Terminalit.
- Drafti i Rregullave të përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL), do të konsultohet me Operatorët në sektorin e Gazit Natyror si dhe gjithë Palët e Interesit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL)” në Shqipëri.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**